

KOMUNIKATË



Federata Kombëtare e Shoqatave Shqiptare Itali, FNAI

Si mbas planifikimit, këshilli drejtues i federatës FNAI, me dt 27.02.2021 realizoi takimim e dytë të saj në bashkëpunim me specialistë dhe ekspertë ligjorë në fushën e emigracionit.

Takimi u drejtua nga **Presidentja** e Federatës *dr. Margita Hoxha* me disa përfaqësues të stafit të federatës: **zv. presidentin** e FNAI-t *Granit Muçaj*, *ing. Erida Çela Perlala*, *ing. Elda Hoxha*, *dr. Adela Shehu* dhe *Petrit R. Aliaj* -**President nderi** i federatës “FNAI”.

Ishte një takim shumë i rëndësishëm nga pikëpamja e shkëmbimit të informacioneve dhe sensibilizimit të opinionit tonë të interesuar prej vitesh për shkak të një indiference dy palëshe, të qeverisë Italiane dhe asaj Shqiptare, në përpjekjet për të arritur nënshkrimin e marrëveshjes (AKORDIT) dypalëshe mbi **Sigurimet Shoqërore** ose zgjidhje tjetër më të shpejtë, që do i jepte mundësimin për daljen në pensjon shumë të moshuarve bashkëatdhetarë, që punojnë në Itali dhe qztetarëve italianë, që punojnë në Shqipëri.

Në takim ishin të ftuar:

On. Cesare Damiano- **Sindikalist** me shumë përvojë, **Deputet** në legjislaturat XV-XVI, **Ministër i Punës** në Qeverinë Prodi, **President i Komisionit XI** të punës publike e private në legjislaturën e shkuar, **këshilltar** në administratën INAIL, **President** i shoqatës “Lavoro & Welfare”, **bashkëautor** i paraqitjes së një varg ndryshimesh dhe përpunimesh ligjore për pensionet dhe kushtetutën Italiane.

Dr. Beskida Aliaj- **Përfaqësuese** dhe **koordinatore** e (INAS)i Institutit Kombëtar të Ndhmës Sociale e CISL-it (Konfederata Italiane e Sindikatave të Punëtorëve) në Tiranë, specialiste në fushën e pensioneve të emigrantëve, **autore** e shumë shkrimeve dhe takimeve me personalitete shqiptare dhe italiane për pensionet.

Ing. Rosario Peta-**Kryetar Bashkie** i Komunës “Piana degli Albanesi”, Palermo, **anëtar** i Grupit Koordinues për Diasporën shqiptare në Itali, **bashkëpunëtor** i federatës “FNAI”.

Av. Gentian Alimadhi- **Avokat penalist**, specialist në fushën e emigracionit dhe autor i një seri shkrimesh për të drejtat e shqiptarëve në Itali, **kandidat** për kryetar bashkie në Parma, **publiçist e moderator** i një seri takimesh, **Ish president** i shoqatës “Skanderbeg” dhe i shoqatës sportive në Parma.

Arch. Giorgio Rubolino -”**Cavalier i Urdhërit të Merituar i Republikës Italiane**”. **President** i ANCIFRA-s (Shoqata Kombëtare e Qytetarëve Italianë e Familjarëve të riatdhesuar nga Shqipëria), **përgjegjës** i zyrës për emigrantët pranë ITAL-UIL të Astit, **autor** i një seri kërkesash për të drejtat e emigrantëve shqiptarë në Itali, **koordinator** i

grupit "Diaspora 91-19", **bashkëpunor** në shoqatat shqiptare të Astit "ASSOALBANIA-PIEMONTE" e "Qendra Kulturore Shqiptare "NËNË TERESA".

Dr. Gerarta Ballo- **Aktiviste** në fushën shoqërore -kulturore, **ish sekretare** në Ambasadën Shqiptare në Romë, **Qytetare Nderi** në komunën Lungro-Kozenza, **kandidate** për deputete në Parlamentin Europian dhe inisiatore e petitionit për të drejtat e pensioneve të emigrantëve në Itali.

Dr. Brizida Haznedari- **Përfaqësuese** ligjore e Koop. "Arcobaleno" Lecco, **këshilltare ligjore** në komunën Lecco, **specialiste** për emigracionin e **autore** e **referuese** për mbrojtjen e të drejtave qytetare për bashkëjetesën shoqërore në Itali, **mediatore kulturele, aktiviste** e Federatës FNAI, pjesë e stafit të shoqatës "Sofra Shqiptare" në Lecco.

Në takim u diskutua mungesa e dëshirës nga shteti Italian dhe ai Shqiptar për të realizuar e nënshkruar **marrëveshjen dypalëshe mbi Sigurimet Shoqërore**, që u jep mundësinë bashkëatdhetarëve, të cilët punojnë në Itali dhe qytetarëve italishtë, që punojnë në Shqipëri të dalin në pension në kushtet ligjore të vëndit, ku banojnë në momentin e duhur.

Deri më sot shteti shqiptar i ka realizuar këto **marrëveshje** me 14 shtete të tjera.

Numri i emigrantëve shqiptarë në Itali është i konsiderueshëm edhe nga pikëpamja e derdhjes së kontributeve të tyre të cilat përgjatë një periudhe 30 vjeçare, ato arrijnë shifrat 13 miliard euro, plus depozitat e tyre me rreth 1 miliard euro në bankat Italiane (viti.2019) Mungesa e parimit të barazisë dhe diskriminimi nga mos zbatimi i Art. 3, 35 e 38 të kushtetutës Italiane do të jetë një tjetër betejë e përbashkët, që duhet të ndjekim në të ardhmen, theksuan oratorët në takim. Ky fakt na detyron të kërkojmë përfshirjen e sa më shumë organizatave e shoqatave të ndryshme shoqërore në Itali për mbështetje në ndërmarrjen e aksioneve konkrete të përbashkëta, me nota proteste në drejtim të shtetit Italian dhe atij Shqiptar. Aksione të cilat do të përfshijnë peticione, protesta e demonstrime të ndryshme për të arritur realizimin e së drejtës për të gëzuar një pension dinjitoz për të gjithë ata, që sot kanë një moshë relativisht të madhe, por edhe për atë brez i cili po punon e duhet ta gëzojë këtë të drejtë.

Këshilli Drejtues i Federatës FNAI.